



Vend i lirë pune

Përshkrimi i punëdhënësit

Medica Gjakova, është organizatë joqeveritare, jofitimpruese që ka për qëllim përmirsimin e shëndetit mendor dhe fizik të grave të mbijetuara të dhunës në baza gjinore gjatë luftës në Kosovë, si dhe integrimin e tyre në të gjitha aspektet e jetës shoqërore. Kjo synohet të arrihet përmes qasjes multidisiplinare duke ofruar shërbime psikosociale, gjinekologjike, këshillime juridike dhe fuqizimin ekonomik, si dhe me aktivitete avokimi për të ndikuar në politikat për përmirsimin e statusit të këtyre grave në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Misioni i shoqatës

Misioni i Medica Gjakovës është që të përmirësojmë gjendjen mendore dhe fizike të grave të mbijetuara nga dhuna si dhe ndikimin mbi politikat sociale në mbështetjen e mirëqenies së grave dhe integrimin e tyre në të gjitha fushat jetësore. Për këtë qëllim, është zhvilluar një strategji e dyfishtë, përfshirë aktivitete të nivelit bazë duke ofruar këshillime psikosociale dhe gjinekologjike, si dhe aktivitete të zhvilluara në nivelin shoqëror dhe politik. Strategjitë sociale dhe politike përfshijnë aktivitete që kanë për qëllim sensibilizimin e shoqërisë dhe qeverisë për gjendjen e vështirë të grave të sulmuara nga lufta dhe nevoja për formësimin e politikave në interes të mirëqenies së grave dhe integrimin e tyre në shoqëri. Duke përdorur këtë qasje të veçantë, Medica Gjakova ndihmon gratë për të kapërcyer stigmatizimin dhe për të thyer këtë temë tabu që është shumë e pranishme dhe ndikon drejtpërdrejt në shkeljen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe të drejtat e grave në veçanti.

Vizioni i shoqatës

Gratë dhe vajzat në Kosovë, jetojnë në shoqëri pa dhunë, të respektuara dhe me dinjitet.

Medica Gjakova është në kërkim të:

Asistente të Projektit

Qëllimi i përgjithshëm i pozitës së punës

Në kuadër të bashkëpunimit të shoqatës Medica Gjakova dhe Fondit të mirëbesimit të Kombeve të bashkuara për të i dhënë fund dhunës ndaj grave (UN Trust Fund to End Violence against Woman), menaxhuar nga UN Woman, Medica Gjakova kërkon të punësojë një punëtoresë për pozitën e punës Asistente e Projektit

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është fuqizimi i grave dhe vajzave në Kosovë; projekti kontribuon në rritjen e shërbimeve për të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave, të zhvillojnë kapacitetet e tyre dhe për këtë arsye parandalojnë konfliktin dhe ndërtojnë paqe të qëndrueshme.



Objektivat e projektit janë:

- Gratë dhe vajzat ndihen më të motivuara, kanë kompetenca më të mëdha vetë-përkrahëse dhe të mbijetuarit fuqizohen përmes mbështetjes në zyrë dhe teren.
- Gratë dhe vajzat angazhohen dhe fuqizohen në aktivitete ekonomike për të u zhvilluar dhe për të gjeneruar të ardhura për veten dhe familjen e tyre.

Për të mbështetur zbatimin e projektit, Medica Gjakova aktualisht është duke kërkuar një Asistente të Projektit, e cila do të asistojë në implementimin e projektit dhe do të menaxhojë kualitetin e produkteve dhe standardet në dyqanin e Medica Gjakovës në Prishtinë.

Pozita e punës fillon me 3 muaj punë provuese.

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore

- Puna do të organizohet në zyrë dhe ne teren në të gjithë territorin e Kosovës, me fokus Gjakovën dhe Prishtinën;
- Asistentja e projektit është përgjegjëse për planifikimin, realizimin, vlerësimin dhe raportimin e aktiviteteve të projektit/dyqanit në përputhje me rregulloret dhe kodet e organizatës;
- Punon ngushtë me stafin për menaxhimin e dyqaneve;
- Bën menaxhimin ditor të dyqanit dhe degëve të tjera të dyqanit;
- Siguron punë financiare përkatëse, kontroll të brendshëm dhe përgatitje të raporteve financiare;
- Siguron që mjetet e Ndërmarrësisë Sociale të mbrohen dhe sigurohen në formë të drejtë;
- Bashkëpunon ngushtë me Menaxheren e Sektorit të Fuqizimit Ekonomik dhe me të gjithë stafin e Medica Gjakovës;
- Është përgjegjëse për implementimin e projekteve;
- Përgatit plane të qëndrueshme për shitje dhe kujdeset që dyqanet përfaqësohen në mënyrë adekuate para anëtarëve, publikut dhe klientëve;
- Organizon punën me efikasitet në zyrë dhe në dyqan;
- Planifikon nevojat operative të dyqaneve;
- Kryen edhe punë të tjera në harmoni me Ligjin, statutin e Ndërmarrësisë Sociale dhe Vendimet e Kuvendit të Anëtarëve;
- Asistentja e projektit është përgjegjëse të përfaqësojë shoqatën në takime të ndryshme apo media;

Kualifikimet e kërkuara, kompetencat dhe eksperiencia e punës

Kualifikimi

Diplomë Universitare në Shkenca Socialea apo fushat tjera relevante.

Eksperiencia e punës

- E preferueshme të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në shoqërin civile apo fusha të tjera të ngjajshme.



Njohuri të tjera, kompetenca shtesë

- Njohuri të Gjuhës Angleze;
- Të posedoj patentë shoferi kategoria “B” dhe e aftë të ngasë mjetet e shoqates;
- Të menduarit analitik dhe startegjik si dhe zotërim të mirë të të shprehurit me shkrim dhe me gojë;
- Qendrim të saktë me qasje të organizuar të punës;
- Aftësi konstruktive komunikuese;
- Gatishmëri dhe aftësi për të përmirësuar aftësitë në fushat e kërkuara nga përgjegjësitë dhe detyrat;
- Aftësi për të mbështetur ekipin e projektit;
- Njohuri digjitale/kompjuterike në programet e Microsoft Office dhe aftësi hulumtuese në Internet;
- Të ketë integritet, fleksibilitet dhe motivim në punë;

Lokacioni: Medica Gjakova, në Gjakovë (punë në zyrë dhe në teren)

Data e parashikuar e fillimit të punes: Tetor 2022 (40 orë në javë)

Si të aplikoni?

Kandidatet e interesuara, të kualifikuara dhe me përvojë ftohen të dorëzojnë aplikacionin e tyre elektronik në gjuhën shqipe apo angleze, në versionin PDF, në adresën medicagjakova@gmail.com

Dokumentet e kërkuara:

- CV (rekomandohet Europass)
- Letër motivuese
- Diploma, referencat dhe rekomandimet
- Email: Emri dhe Mbiemri – Asistente Administrative – Medica Gjakova

Aplikueset që nuk i plotësojnë kriteret e lartëcekura nuk do të konsiderohen për fazën tjetër të rekrutimit! Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen dhe do të ftohen në fazën tjetër të rekrutimit

Afati i fundit për aplikim: **09 tetor 2022**

Medica Gjakova inkurajon kandidatët femra, kandidatët nga komunitetet etnike si dhe kandidatët me aftësi të kufizuara që të aplikojnë.